



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë , më

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME

ME OBJEKT

**“SHERBIM PASTRIMI DHE LARGIMI I MBETJEVE URBANE PER QYTETIN
FUSHE KRUJE ”**

KONTRATE ME AFAT VLEFSHMERIE 12 MUAJ

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me date 05.08.2024 ne Kruje, nga ana e Njesise se Prokurimit, sipas Urdherit te Prokurimit nr.321 datë, 05.08.2024 , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “ **E Hapur mbi kufirin e larte monetar**”, dhe ne referim te urdherit te prokurimit **nr.321 Date** 05.08.2024, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sherbim Pastrimi dhe Largimi i Mbetjeve Urbane per Qytetin Fushe Kruje ”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 90522400-6 - Pastrimi dhe trajtimi i tokës

VLERA E FONDIT LIMIT: Fond limit total (vlere e pritshme e kontratave te lidhura gjate periudhes se marreveshjes kuader) ne shumen prej **19 730 391 (nentembedhjete million e shtaterqind e tridhjete mije e treqind e nentendhjete e nje) lekë pa tvsh.**

***Kursi i kembimit zyrtar sipas Bankes se Shqiperise me date 05.08.2024 eshte 1 Euro = 100.21 (njqind pike njezet e nje) leke**

Burimi i financimit: Te ardhurat e Bashkise Kruje te miratuar me VKB nr. 77 date 22.12.2023 ”Per miratimin e buxhetit te vitit 2024” ndryshuar.

Procedura e prokurimit do të jetë e llojit Kontrate **12 (dymbëdhjete) muaj** mbështetur në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar ,VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ”, i ndryshuar

Kërkesat e autoritetit kontraktor Bashkia Krujë, janë realizimi i vazhdueshëm, eficient dhe me cilësi i shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeje urbane).

Për këtë arsye, kërkesa e Bashkisë është që shërbimi i pastrimit të kryhet me mjete teknologjike bashkohore, me staf të specializuar dhe eficientë. Të gjitha këto kërkesa përkthehen në shërbime cilësore dhe mjedis sa më të pastër.

Kontrata synon krijon një raport më të mirë ndërmjet kërkesës se Autoritetit Kontraktor për shërbime cilësore dhe kostos që kanë operatorët ekonomikë për ti ofruar këto shërbime me kapacitete optimale.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Krujë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1-a) Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2024 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2024 për secilin operator)*

Shenim- Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2024 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2024 për secilin operator).*

Shenim- Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetencën të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a)-Liçencë të vlefshme të shoqërisë së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL)/Autoriteti kompetent sipas ligjit, Kategoria III.2 “ Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, Nënkatëgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi liçenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.b-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3(tre) vitet financiare (2021’2022’2023), ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vleras e fondit limit të kontratës që prokurohet përkatësisht në shumën prej, **19.730.391 lekë pa tvsh**

Shenim-Pika 2.2-b) plotësohet duke paraqitur vertetimin përkatës të Administratës Tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” “*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*”, “*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”... *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia Krujë dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit të kontrates/lotit që prokurohet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Vlera e marzhit të xhiros se kerkuar në kufirin e percaktuar si me sipër konsiderohet tregues i rendesishem për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e një kufiri të ulët dhe iu jep mundësi në nder të tjera e dhe operatoreve ekonomik të vegjël dhe të mesëm të kenë akses në oferte.

2.2-a) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet financiare (2021-2022-2023), të certifikuara nga autoritetet përkatëse kompetente (Drejtorite Rajonale të Tatimeve) , që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse ne treguesit e bilanceve per dy vite te njeplasnjeshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

a)Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për shërbime te mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates me një vlerë jo me te vogel se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet .

Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur shërbimet e mëparshme te ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontrates si dhe fatura tatimore të shitjes,të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Kur shërbimet e mëparshme te ngjashme janë realizuar me subjekte private,Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore te shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “ Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4. “*në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të*

përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është në vlerën kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë e Fushe Kruje), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.4- Personeli dhe fuqia punetore:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, 1(nje) Drejtues Teknik të shërbimit të pastrimit për **objektin e kontratës**, të cilin duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme (me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit të shërbimit për këtë objekt), diploma dhe CV.

Shenim- Për të përmbushur këto kritere në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”* dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij,

është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vërtetohen në CV përkatëse të tij.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

OE duhet të deklarojë se ka në stafin e tij punonjësit e kërkuar për kryerjen e shërbimit, të punësuar, e vërtetuar me listë pagesat për periudhën Maj 2024 e në vazhdim si më poshtë:

- 1 drejtues Teknik
- 5 (pese) shofer vërtetuar me kontratë pune të vlefshme të ndare si më poshtë:
 - o 4 Shoferë kamionash të pajisur me Leje Drejtimi përkatëse për shofer kamioni dhe me Certifikatë Aftësimi Profesional (ÇAP)
 - o 1 Manovratore (Eskavatoriste) të pajisur me Dëshmi Aftësimi Profesionale leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Një punësim i të paktën 11 (njëmbëdhjetë) punonjësish krahu të figurojnë të punësuar pranë shoqërisë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme;
- Punonjësit (drejtuesi teknik, shoferet dhe punonjësit e krahut) të figurojnë të punësuar pranë shoqërisë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme;

Vërtetim të leshuar nga Dega e Tatimeve të Qarkut ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të qarkut përkatëse ose vërtetim leshuar nga platforma elektronike E-Albania .

ose

Listepagesat për periudhën e mesipërme (E-sig 025) sipas formatit elektronik në përputhje me VKM nr 922 datë 29.12.2014” **Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”**

Shënim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës, (sipas analizave të kostos të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve Publike .

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Po t'i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.5-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

Autofshesë me kapacitet 3 - 4 m ³ ,me fshesa rrul e flutur.	copë	1	Pronesia
Kamion veteshkarkues me peshe mbajtese 5 ton	Cope	1	Pronesi ose qera
Fadrome me goma me kapacitet te koves 0.25-1 m ³	cope	1	Pronesi ose qera
Autobot uji për larje/larje speciale rrugësh.	copë	1	Pronesi ose qera
Kontenjere mbeturinash 1100l (1.1 m ³)	cope	22	Pronesi ose qera
Kamjon teknologjik plehërash(kompaktor) me kapacitet 6 - 8 m ³	cope	1	Pronesi ose qera
Kamjon teknologjik plehërash(kompaktor) me kapacitet 8 -10 m ³	cope	1	Pronesi ose qera

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit,*

(e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- b) Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 09. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fushe Kruje. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).

Shenim- Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe pajisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zerat e shërbimit.

Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjetstim më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës si dhe percaktimeve ligjore ne Kodin Civil.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

- **Specifikimet Teknike** per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Sherbimeve dhe Investimeve Publike qe ka hartuar edhe elementet e tjere plotesues te dokumentacionit teknik te perkates te ekzekutimit te kontrates duke qene elemente perberes te tij dhe qe jane administruar nga ana e Njesise se Prokurimit Publik me shkresen **nr .4971 prot date 02.08.2024**. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te menaxhimit te integruar te mbetjeve urbane ne Republiken e Shqiperise ,

Ofrimi i këtij shërbimi do te mbylle ciklin e menaxhimit te mbetjeve ne qytetin e Fushe krujes Bashkine Fushe kruje

Zërat e shërbimeve janë hartuar bazuar në baza e metodologjie te mirepercaktuara ,duke marre ne konsiderat pervojen shumevjecare te Bashkise Fushe kruje ne menaxhimin e integruar te mbetjeve urbane, si dhe duke permiresuar standartet e ketij sherbimi me qasjet e fundit te politikave te menaxhimit te integruar te mbetjeve urbane, specifikisht sipas orientimeve te Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011” Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” .

Specifikimet Teknike dhe Dokumentacioni plotesues teknik justifikues jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

- **Fondi Limit** i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te *kerkesave specifike te nenit 34 te Ligjit nr 162/2020 ”Per Prokurimin Publik” dhe nenit 76. te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Cmimet reference te preventivit per cdo ze jane hartuar sipas analizave te detajuara te kosos ne perputhje me VKM nr.319 datë 31.05.2018 “ Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të inttegruar të mbetjeve “, dhe VKM nr.629 date 15.07.2015 “Per manualet teknike te ndërimit dhe analizat e çmimeve te tyre”.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe

çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT